



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT
DHE SPORTIT

No. Prot.

Tiranë, më 12.01.....2017

MIRATOHET
MINISTËR



LINDITA NIKOLLA

MATURA SHTETËRORE
PROGRAMET ORIENTUESE

(Provim me zgjedhje)

LËNDA: EKONOMI E THELLUAR

Koordinator: ASTRIT DAUTAJ

Viti shkollor 2016-2017

1. UDHËZIME PËR ZBATIMIN E PROGRAMIT

Programi orientues i Maturës Shtetërore për lëndën “Ekonomi e thelluar”, përfshin konceptet më të rëndësishme të ekonomisë, njohuritë dhe aftësitë themelore që i duhen nxënësit në këtë lëndë. Programi orientues i Maturës Shtetërore për provimin me zgjedhje të lëndës “Ekonomi e thelluar”, për vitin shkollor 2016-2017, përbën një dokument të vlefshëm për mësuesit e gjimnazit, nxënësit e interesuar dhe specialistët e përfshirë në procesin e hartimit dhe vlerësimit të testit të maturës shtetërore.

- Programi përmban dhe siguron informacionin e nevojshëm për mësuesit e ekonomisë së gjimnazit që do të përgatisin maturanët për provimin e lëndës “Ekonomi e thelluar”, si lëndë me zgjedhje në maturën shtetërore.
- Programi orienton nxënësit për njohuritë, konceptet dhe aftësitë kryesore që duhet të zotërojnë për të përballuar me sukses provimin e lëndës “Ekonomi e thelluar”, si lëndë me zgjedhje në maturën shtetërore.
- Programi përbën një dokument zyrtar që duhet zbatuar me korrektesë nga specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të lëndës “Ekonomi e thelluar” si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore.

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes nga secili prej grupeve të interesit. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të lëndës “Ekonomi e thelluar” si lëndë me zgjedhje për maturën shtetërore, duhet të mbajnë në vëmendje që nuk duhet të përfshijnë për vlerësim objektiva mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Banka e pyetjeve dhe teza e provimit duhet të përmbajnë vetëm ato koncepte, njohuri dhe aftësi të parashikuara në këtë program.

Mësuesit që do të përgatitin nxënësit për provimin e lëndës “Ekonomi e thelluar” t’i aftësojnë nxënësit jo vetëm për çështjet mësimore, njohuritë, konceptet dhe shprehjet e përcaktuara në këtë program, por të trajtojnë me ta edhe çështje që nuk trajtohen në tekstin e përzgjedhur, por që përmbajnë informacion të rëndësishëm dhe ndihmojnë nxënësit për të përvetësuar më mirë materialin e zgjedhur për provim.

Përgatitja e nxënësve për provimin e lëndës “Ekonomi e thelluar” të bëhet në mënyrë të vazhdueshme, që nxënësit të sigurojnë cilësinë e nxënies së çështjeve mësimore, të koncepteve kyçe dhe të aftësive intelektuale të përcaktuara në program.

Kujdes!

Në rastet kur njëri prej teksteve alternative nuk trajton një objektivi të caktuar të programit, atëherë **mësuesi i lëndës, që ka përzgjedhur këtë tekst, ka detyrën të plotësojë informacionin e domosdoshëm për realizimin e objektivit të përcaktuar.**

Nuk është detyrë e nxënësit të sigurojë tekste të tjera për të realizuar objektivat e munguar!

1.1 UDHËZIM I VEÇANTË

Testi në provimin me zgjedhje të maturës shtetërore në lëndën “Ekonomi e thelluar”, do të ndërtohet në bazë të kërkesave dhe objektivave të programit të lëndës “**Ekonomi-Bërthamë**” dhe “**Ekonomi e thelluar**”.

Testi **synon të vlerësojë atë çfarë di dhe është i aftë të bëjë nxënësi në fund të shkollës së mesme në lëndën e ekonomisë bërthamë dhe të thelluar**, duke u bazuar në kërkesat e programit dhe në mundësitë që ofrojnë tekstet.

Kjo do të thotë se:

- a. Maturanti testohet për të vlerësuar shkallën e përvetësimit prej tij të njohurive, të ideve dhe të koncepteve bazë të lëndës. Programi në vijim përmban pikërisht fushat, temat, çështjet dhe konceptet kryesore të përzgjedhura për t’u testuar në këtë provim.
- b. Maturanti testohet për aftësitë intelektuale të vëzhgueshme dhe të matshme, të synuara nga programi dhe të zhvilluara gjatë në lëndën e qytetarisë në shkollë, të tilla si:
 1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar (nivel i ulët i aftësive intelektuale).
 2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar (nivel mesatar i aftësive intelektuale).
 3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara (nivel i lartë i aftësive intelektuale).

1. Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar

- **Të identifikosh** do të thotë të zbulosh kuptimin e gjërave të prekshme (p. sh., toka, vegla pune etj.) ose jo të prekshme (p.sh., kërkesa, oferta.). Të identifikosh diçka, do të thotë ta dallosh atë nga diçka tjetër, ta klasifikosh ose ta gruposh sipas ngjashmërisë etj. Për shembull, nxënësi të identifikojë faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim
- **Të përshkruash** do të thotë të dallosh, me shkrim ose me gojë, karakteristikat kryesore të një sendi ose dukurie. Këto mund të jenë sende të prekshme, konkrete, por mund të jenë edhe procese, institucione, qëllime etj. Për shembull, nxënësi të përshkruajë rëndësinë ekonomike të konsumatorit në ekonominë e tregut si dhe burimet e të ardhurave të individëve dhe format e tyre

2. Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar

- **Të shpjegosh** do të thotë të identifikosh, të përshkruash, të qartësosh ose të interpretosh diçka, p.sh.: shkaqet e ngjarjeve, kuptimin e ngjarjeve ose ideve të caktuara, arsyet për ndërmarrjen e veprimeve ose qëndrimeve të caktuara. Për shembull, nxënësi të shpjegojë konceptet pamjaftueshmëri, sistem ekonomik, kosto oportune dhe lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur...
- **Të analizosh** do të thotë të ndash diçka në pjesët e saj përbërëse për të qartësuar kuptimin ose rëndësinë e saj, për shembull, për të kuptuar shkaqet e ngjarjeve, pjesët përbërëse dhe pasojat e ideve, e proceseve të caktuara shoqërore, politike

ose ekonomike. Për shembull, nxënësi të analizojë ndërveprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në çmimin ekuilibër

3. Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur qëndrime të caktuara

- **Të vlerësosh** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të gjykuar, p.sh., për anët e forta ose të dobëta të qëndrimeve që lidhen me çështje të caktuara, synime, mjete etj. Për shembull, nxënësi të vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të elasticitetit të kërkesës në sasinë e kërkuar.
- **Të marrësh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh kritere ose standarde për të arritur në një qëndrim që individi e zgjedh nga një numër i caktuar qëndrimesh ose në një qëndrim të ri. Për shembull, nxënësi të mbajë qëndrimin e tij për shkallën e ndërhyrjes së shtetit në ekonominë e tregut.
- **Të mbrosh një qëndrim të caktuar** do të thotë të përdorësh argumente dhe fakte që mbështetin atë qëndrim, ose të kundërshtosh një qëndrim të caktuar, duke marrë parasysh edhe argumentet që i kundërvihen qëndrimit tënd. Për shembull, nxënësi të mbrojë me argumente qëndrimin e tij për politikën e rritjes ose të uljes së taksave, duke mbajtur parasysh të gjitha argumentet e kundërta me të tija.

Model i shpërndarjes së pikëve që rrjedhin nga pyetje të niveleve të ndryshme në test

Nivelet e aftësive intelektuale		
Niveli i ulët Aftësia për të identifikuar dhe për të përshkruar...	Niveli mesatar Aftësia për të shpjeguar dhe për të analizuar...	Niveli lartë Aftësia për të vlerësuar, për të marrë dhe për të mbrojtur një qëndrim të caktuar...
40%	40%	20%

Shembuj rezultatesh komplekse të nxëni, që mund të maten/vlerësohen:

1. me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, të cilët nxënësi, pasi i lexon ose i analizon në një material të caktuar informativ, i plotëson me një ose me më shumë detyra;
2. me anë të testeve me përgjigje të kufizuara;
3. me anë të testeve me përgjigje të zgjeruara.

1. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të testeve që varen nga një kontekst i caktuar, janë, për shembull, aftësitë:

- për të dalluar lidhjet shkak-pasojë;
- për të dalluar zbatimin e parimeve;
- për të dalluar argumentet që kanë lidhje me çështjen;
- për të dalluar hipoteza të arsyeshme;
- për të dalluar përfundime të vlefshme etj.

2. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të esëve me përgjigje të kufizuara, janë, për shembull, aftësitë:

- për të shpjeguar lidhjet shkak-pasojë;
- për të përshkruar zbatimin e parimeve;
- për të paraqitur argumente të vlefshme;
- për të formuluar hipoteza të arsyeshme;
- për të formuluar përfundime të vlefshme.

3. Rezultate të nxëni, që mund të vlerësohen me anë të esëve me përgjigje të zgjeruara, janë, për shembull, aftësitë:

- për të prodhuar, për të organizuar dhe për të shprehur ide;
- për të lidhur të nxënit në fusha të ndryshme të dijes;
- për të krijuar modele origjinale;
- për të vlerësuar ide të vlefshme.

2. LINJAT DHE NËNLINJAT

A. EKONOMIA BËRTHAMË

LINJA 1: EKONOMIA E TREGUT

Nënlinja	Objektivat
1.1 Çfarë studion ekonomia?	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• të shpjegojë konceptet pamjaftueshmëri, sistem ekonomik, kosto oportune dhe lidhjen shkakësore ndërmjet pamjaftueshmërisë dhe nevojës për të zgjedhur, duke pranuar koston oportune.• të japë shembuj personal lidhur me marrjen e vendimeve dhe koston oportune të saj;• të identifikojë faktorët e prodhimit për një të mirë ose shërbim;• të interpretojë një lakore të mundësive të prodhimit si dhe nëpërmjet saj të ilustrojë koston oportune”;• të vlerësojë mënyrën se si sisteme të ndryshme ekonomike e zgjidhin problemin ekonomik themelor;• të përshkruajë veçoritë e shtyllave të sistemit ekonomik të iniciativës së lirë;• të përshkruajë rolin e fitimit në sistemin e sipërmarrjes së lirë;• të analizojë se si ndërmarrja e iniciativave ekonomike nxit përdorimin e burimeve natyrore, të kapitalit fizik dhe njerëzor;• të përshkruajë fluksin e qarkullimit të aktivitetit ekonomik që lidh familjet, firmat e biznesit dhe qeveritë në ekonominë e tregut.
1.2. Kërkesa oferta dhe çmimi i tregut	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• të interpretojë konceptet: treg, çmim, kërkesë, ofertë;• të formulojë ligjin e kërkesës dhe ofertës;• të interpretojë lakoren e kërkesës dhe ofertës;• të shpjegojë faktorët që shkaktojnë zhvendosjen e kërkesës dhe ofertës;• të përcaktojë çmimin ekuilibër të një produkti të dhënë kur janë dhënë kërkesa dhe oferta për këtë produkt nëpërmjet grafikut;• të bëjë dallimin midis një ndryshimi në sasinë e kërkuar, apo ofruar dhe një ndryshimi në kërkesë, apo ofertë;• të vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të elasticitetit të kërkesës në sasinë e kërkuar dhe të ndryshimeve të elasticitetit të ofertës në sasinë e ofruar.• të shpjegojë se si ndikojnë në çmimin e tregut ndryshimet në kërkesë dhe ofertë;• të analizojë ndërveprimin e ligjit të kërkesës dhe ofertës në çmimin ekuilibër;• të shpjegojë se si çmimet e tregut bëjnë racionimin e mallrave dhe shërbimeve dhe motivojnë njerëzit për prodhimin e tyre;• të vlerësojë se si sistemi i tregut siguron plotësimin e nevojave të konsumatorëve;• të dallojë çmimin tavan nga çmimi dysheme;

	<ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë se si ndërhyrja e qeverisë mund të ndikojë tek tregu dhe sesi çmimet e tregut ofrojnë informacion dhe nxitje për konsumatorët dhe prodhuesit. • të analizojë raportin kosto-përfitim lidhur me ndërhyrjen e qeverisë në përcaktimin e çmimit të disa produkteve
1.3. Konsumatori në ekonominë e tregut	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë rëndësinë ekonomike të konsumatorit në ekonominë e tregut si dhe burimet e të ardhurave të individëve dhe format e tyre; • të shpjegojë arsyet pse njerëzit kursejnë; • të krahasojë metodat e ndryshme të kursimit; • të analizojë faktorët që ndikojnë në masën e kursimit; • të përgatisë një buxhet personal; • të shpjegojë avantazhet dhe disavantazhet e blerjes me kredi.
1.4. Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë se si tregu i lirë inkurajon sipërmarrjen; • të listojë format kryesore të organizimit të biznesit. • të gjykojë mbi avantazhet dhe disavantazhet e secilës prej tri formave kryesore të biznesit; • të shpjegojë organizimin e korporatës • të gjykojë mbi disa nga përgjegjësitë, kërkesat dhe përfitimet që lidhen me sipërmarrjen; • të dallojë burimet e brendshme nga burimet e jashtme të financimit të biznesit; • të shpjegojë qëllimet dhe format e burimeve financiare të biznesit; • të dallojë ndryshimin midis aksionit dhe obligacionit; • të analizojë një bilanc dhe një pasqyrë të rezultateve financiare të firmës.
1.5. Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të bëjë dallimin midis kostove fikse dhe atyre variabël; • të llogarisë koston e përgjithshme të prodhimit, koston mesatare dhe atë marxhinale; • të interpretojë grafikun e kostos fikse, variabël, të përgjithshme, mesatare, marxhinale; • të llogarisë të ardhurat e përgjithshme, të ardhurat marxhinale dhe të ardhurat mesatare; • të llogarisë produktin e përgjithshëm fizik, marxhinal, mesatar; • të zbulojë veprimin e ligjit të të ardhurave zbritëse në gjendjen e biznesit. • të shpjegojë funksionin e prodhimit për periudhën afat shkurtër
1.6. Struktura e tregut	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të interpretojë konceptet e konkurrencës dhe strukturës së tregut; • të identifikojë nivelin e konkurrencës së tregjeve në ekonomi;

	<ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë karakteristikat e secilës nga strukturat kryesore të tregjeve: konkurrencë e plotë, konkurrencë monopoliste, oligopol, monopol. • të diskutojë raportet dhe format e shkrirjes së bizneseve; • të krahasojë strukturat e ndryshme të tregjeve; • të analizojë efektet ekonomike të strukturave të tregut mbi ekonominë dhe konsumatorin; • të argumentojë se zhvillimi i konkurrencës së lirë është në favor të të gjithë subjekteve në ekonominë e tregut.
1.7 Tregjet e faktorëve të prodhimit	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të interpretojë ofertën dhe kërkesën për faktorët e prodhimit; ▪ të interpretojë ofertën për punë dhe kërkesën për punë; ▪ të shpjegojë se si kërkesa dhe oferta për punë përcaktojnë çmimin e punës, çmimin e kapitalit, çmimin e tokës; ▪ të vlerësojë shkallën në të cilën forcat e tregut dhe forcat jo të tregut ndikojnë në pagat.

LINJA 2: EKONOMIA KOMBËTARE

Nënlinja	Objektivat
2.1. Qeveria dhe ekonomia	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë funksionin e qeverisë si arbitër dhe si subjekt në ekonominë e tregut; • të shpjegojë pse pjesëmarrja e qeverisë në ekonomi është rritur gjatë viteve; • të përshkruajë disa nga të ardhurat kryesore dhe shpenzimet në buxhetin për qeverinë shqiptare; • të shpjegojë arsyet që qeveria vendos taksa dhe pse taksimi nga qeveria është i nevojshëm; • të vlerësojë taksat, bazuar në parimet e vendosjes së tyre. • të krahasojë tipat e ndryshme të taksave, duke përfshirë taksat progresive, regresive dhe proporcionale; • të interpretojë konceptet e deficitit buxhetor, e borxhit publik dhe lidhjen midis tyre; • të analizojë përparësitë dhe mangësitë e deficitit buxhetor dhe borxhit publik; • të përshkruajë një ose disa propozime për të ulur deficitin buxhetor.
2.2. Paraja dhe institucionet financiare	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të interpretojë konceptin e parasë dhe karakteristikat e saj dhe funksionet e parasë në një ekonomi monetare; • të përshkruajë procesin e lindjes dhe të zhvillimit të parasë duke evidentuar format e saj; • të identifikojë tipat e parasë në qarkullim, në vendin tonë. • të shpjegojë: ofertën monetare, rolin e veçantë të bankave si

	<p>pranuese depozitash dhe dhënese huash për ekonominë si dhe domosdoshmërinë e rezervës së detyrueshme bankare;</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë organizimin dhe funksionet e Bankës Qendrore të Shqipërisë.
2.3 Treguesit kryesorë makroekonomik	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë treguesit që përdoren për të matur gjendjen e ekonomisë; • të shpjegojë konceptin e GDP dhe se çfarë përfshihet në llogaritjen e GDP; • të bëjë dallimin midis GDP reale dhe GDP nominale; • të analizojë kuptimin e GDP për frymë e shprehur në çmime aktuale dhe çmime konstante; • të përshkruajë metodat e matjes së GDP; • të japë kuptimin për inflacionin, deflacionin; • të dallojë inflacionin e shkaktuar nga kostoja nga inflacioni i shkaktuar nga kërkesa; • të shpjegojë ndikimin ekonomik të inflacionit dhe format kryesore të inflacionit; • të shpjegojë fazat kryesore të ciklit të biznesit. • të shpjegojë konceptin e forcës punëtore; • të dallojë format kryesore të papunësisë.
2.4. Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përshkruajë mjetet e politikës fiskale. • të shpjegojë pse politikat fiskale janë vendime për të ndryshuar shpenzimet dhe/ose taksat nga qeveria; • të interpretojë efektet direkte dhe indirekte të politikës fiskale në papunësinë, prodhimin dhe normat e interesit; • të përshkruajë instrumentet e politikës monetare; • të dallojë instrumentet e politikës monetare nga ato të politikës fiskale; • të përshkruajë ndikimet dhe kufizimet e politikës fiskale si dhe ndikimet dhe kufizimet e politikës monetare; • të identifikojë rrugët në të cilat politika monetare ndikon në papunësinë, prodhimin, inflacionin dhe normat e interesit.

LINJA 3: MARRËDHENIET EKONOMIKE NDËRKOMBËTARE

Nënlinja	Objektivat
3.1 Tregtia ndërkombëtare	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë konceptet e përparësisë absolute dhe krahasuese; • të argumentojë përfitimet që kanë vendet e industrializuara kur këmbëjnë midis tyre;

	<ul style="list-style-type: none"> • të analizojë përmbajtjen e tregtisë së lirë dhe përfitimet ekonomike të saj; • të përshkruajë disa pengesa në tregtinë ndërkombëtare; • të japë në mënyrë të përmbledhur, argumentet që favorizojnë tregtinë e lirë; • të përshkruajë pse luhaten kurset e këmbimit valutor; • të bëjë dallimin midis bilancit të pagesave dhe bilancit tregtar.
--	--

3. PESHAT E LINJAVE DHE NËNLINJAVE

LINJA/NENLINJA	PESHA NE %
Linja 1	56%
1.1 Çfarë studion ekonomia?	10%
1.2. Kërkesa oferta dhe çmimi i tregut	19%
1.3. Konsumatori në ekonominë e tregut	3 %
1.4. Fillimi i një biznesi dhe financimi i tij	11%
1.5. Prodhimi, kostoja dhe të ardhurat e firmës	7%
1.6. Struktura e tregut	6%
Linja 2	39%
2.1. Qeveria dhe ekonomia	11%
2.2. Paraja dhe institucionet financiare	6%
2.3 Treguesit kryesorë makroekonomik	16%
2.4. Stabiliteti ekonomik dhe politikat makroekonomike	6%
Linja 3	5%
3.1 Tregtia ndërkombëtare	5%
Totali	100%

B. EKONOMI E THELLUAR

LINJA 1: EKONOMIA E TREGUT

Nënlinja	Objektivat
1.1. Qëllimet sociale të një ekonomie	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• të shpjegojë objektivat sociale të një ekonomie;• të krahasojë sistemet ekonomike duke u bazuar në kriteret dhe qëllimet sociale;• të analizojë dhe vlerësojë mënyrën se si sisteme të ndryshme ekonomike plotësojnë qëllimet kryesore ekonomike.
1.2. Kërkesa dhe oferta: si funksionojnë tregjet	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• të analizojë elasticitetin e kërkesës dhe të ofertës në lidhje me çmimin;• të llogaritë koeficientin e elasticitetit të kërkesës dhe të ofertës në lidhje me çmimin duke nxjerrë konkluzione bazuar në të;• të identifikojë mallra elastike, jo elastike në kërkesë dhe ofertë.• të analizojë faktorët që ndikojnë në elasticitetin në kërkesë dhe ofertë;• të interpretojë lakoren e mallrave elastike, jo-elastike dhe me elasticitet njësi, në kërkesë dhe ofertë.• të vlerësojë ndikimin e ndryshimeve të elasticitetit të kërkesës në sasinë e kërkuar dhe të ndryshimeve të elasticitetit të ofertës në sasinë e ofruar;• të shpjegojë lloje të tjera elasticiteti, si elasticiteti i kërkesës lidhur me të ardhurat dhe elasticiteti i tërthortë i kërkesës dhe si ndërveprojnë tregjet e produkteve dhe të faktorëve të prodhimit me njëri-tjetrin;• të analizojë pasojat e ndryshimeve në kërkesë dhe ofertë për një produkt, faktorë të caktuar prodhimi, që vijnë si rezultat i ndryshimeve që pësojnë hap pas hapi produkte dhe faktorë të tjerë prodhimi;• të analizojë efektet e politikave të ndryshme qeveritare mbi kontrollin e çmimeve në një ekonomi.
1.3. Sjellja konsumatore dhe maksimizimi i dobishmërisë	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none">• të interpretojë dobishmërinë marxhinale zbritëse dhe ligjin e dobishmërisë marxhinale zbritëse;• të ndërtojë dhe argumentojë lakoret e indiferencës dhe të gjejë ekuilibrin e konsumatorit;• të argumentojë maksimizimin e dobishmërisë në përndarjen e të ardhura në para;• të argumentojë zgjedhjet e bëra në shpenzimin e të ardhurave në para të kufizuara, bazuar në preferenca të mirë përcaktuara;• të argumentojë zgjedhjet e bëra si individ konsumator në shpërndarjen

	e të ardhurave.
1.4. Sipërmarrës i suksesshëm. Si të bëhesh i tillë	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të analizojë si mund të bëhesh sipërmarrës i suksesshëm; • të interpretojë konceptin e sipërmarrjes dhe të sipërmarrësit dhe tiparet, cilësitë e sipërmarrësve; • të vlerësojë veprimtari sipërmarrjesh e sipërmarrësish; • të analizojë sfidat dhe përfitimet e sipërmarrjes së lirë; • të diskutojë mbi strategjitë që përdorin sipërmarrës të ndryshëm për të arritur suksesin e tyre; • të analizojë përparësitë dhe mangësitë e biznesit të vogël dhe të vlerësojë rolin që ka ky biznes në sistemin e ekonomisë së tregut. • të analizojë etikën e sipërmarrësve, format e promocionit dhe të ballafaqimit me konsumatorin në treg.
1.5. Prodhimi, produktiviteti dhe tregu i punës	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë funksionin e prodhimit në periudhën afatshkurtër/afatgjatë dhe pse ka rënie prodhimi në periudha afatshkurtër; • të analizojë vendimmarrjet e bizneseve mbi prodhimin në periudhën afatgjatë/afatshkurtër; • të llogarisë prodhueshmërinë dhe japë kuptimin e saj; • të bëjë dallimin midis prodhimit dhe prodhueshmërisë; • të analizojë faktorët që ndikojnë në prodhueshmëri dhe efektet që kanë ato në standardin e jetesës së vendit. • të shpjegojë funksionimin e tregut të punës; • të analizojë përcaktimin e pagave për kategori të ndryshme pune si dhe veprimin e forcave jashtë tregut në vendosjen e pagave; • të analizojë zhvillimet e fundit në marrëdhëniet punë –menaxhim.
1.6. Analizë krahasuese e strukturave të tregut dhe rregullimi i monopolit	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të përcaktojë nivelin e prodhimit në të cilën firmat maksimizojnë fitimin në struktura të ndryshme tregu; • të analizojë vendimmarrjet e firmave në struktura të ndryshme tregu si dhe sjelljet e firmave në struktura të ndryshme tregu si në periudhën afatshkurtër dhe në periudhën afatgjatë; • të analizojë efektet ekonomike të strukturave të tregut mbi ekonominë dhe konsumatorin. • të analizojë dhe argumentojë domosdoshmërinë e politikave shtetërore mbi kontrollin e monopolit.

Nënlinja	Objektivat
2.1. Roli i qeverisë në ekonomi, një vështrim i gjerë	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të argumentojë domosdoshmërinë e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi. • të analizojë rritjen e ndërhyrjes së shtetit në ekonomi si dhe efikasitetin e përdorimit të burimeve të alokuara në sektorin publik; • të analizojë disa nga problemet me të cilat përballet qeveria në realizimin e veprimtarisë së saj ekonomike si dhe politika të ndryshme të qeverisë mbi ligjet antimonopol, zhvillimin dhe mbështetjen e sektorit privat, reduktimin e varfërisë, ndotjen e mjedisit etj; • të shpjegojë ndikimin e taksimit dhe vendimmarrjet e qeverisë për politika sociale ndaj subjekteve të veçanta.
2.2. Politika monetare dhe mekanizmi i transmissioinit	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë komponentët e ofertës monetare dhe përbërësit e tyre dhe se si krijon para sistemi bankar duke dhënë kredi; • të analizojë objektivat, qëllimet dhe instrumentet e politikës monetare; • të shpjegojë instrumentet bazë monetare dhe përdorimin e tyre; • të analizojë efektin e instrumenteve monetare në stabilizimin e çmimeve, rritjen ekonomike; • të shpjegojë si Banka Qendrore rregullon ofertën monetare për të nxitur punësimin dhe stabilitetin e çmimeve; • të argumentojë përgjegjësitë e qeverisë në stabilizimin e vlerës së njësisë monetare, që përfshin aplikimin e një politike fiskale dhe kontrolli efektiv mbi ofertën e parasë; • të vlerësojë se si funksionon politika monetare (anët e forta dhe dobësitë e politikës monetare).
2.3. Njohuri të thelluara makroekonomike	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të analizojë kuptimin e GDP për frymë e shprehur në çmime aktuale dhe çmime konstante; • të shpjegojë thelbin e metodës së prodhimit, shpenzimeve dhe të ardhurave në matjen e produktit të përgjithshëm dhe të llogaritë produktin e përgjithshëm sipas metodës së shpenzimeve, të të ardhurave dhe të prodhimit. • të shpjegojë kërkesën tërësore dhe faktorët që ndikojnë në të. • të krahasojë modelin makroekonomik klasik dhe atë kejsian të ekuilibrit. • të llogarisë normën e inflacionit dhe normën e papunësisë; • të analizojë raportin midis papunësisë dhe inflacionit si dhe lidhjen e përgjithshme makroekonomike, nëpërmjet agregimit të treguesve ekonomike.

LINJA 3: MARRËDHËNIET EKONOMIKE NDËRKOMBËTARE

Nënlinja	Objektivat
3.1. Bashkëpunimi ekonomik dhe proceset integruese	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> ▪ të shpjegojë thelbin e bashkëpunimit ekonomik midis vendeve si dhe hapat e proceset integruese në këtë bashkëpunim ekonomik; ▪ të analizojë përfitimet e vendeve nga ky bashkëpunim dhe integrim ekonomik si dhe ecurinë e tregtisë me jashtë të vendit tonë në kushtet e integritimit ekonomik në rajon dhe Evropë; ▪ të shpjegojë MTL, MSA, dhe përfitimet reciproke të vendeve që zbatojnë këto marrëveshje; ▪ të analizojë pozicionin dhe nivelin e përfshirjes së Shqipërisë në këtë proces integrues ekonomik.
3.2. Zhvillimi ekonomik dhe varfëria	<p>Në fund të kësaj njësie mësimore nxënës/i,-ja:</p> <ul style="list-style-type: none"> • të shpjegojë se mirëqenia e një vendi varet nga niveli i zhvillimit ekonomik të tij; • të bëjë krahasimin e varfërisë absolute dhe relative, si domosdoshmëri për të analizuar nivelin e varfërisë reale të një vendi; • të analizojë tregues të nivelit të varfërisë në vendin tonë dhe të nxjerrë konkluzione nga kjo analizë; • të shpjegojë politika ekonomike të qeverisë mbi reduktimin e varfërisë duke konkluduar në efektin që ato kanë.

3. PESHAT E LINJAVE DHE NËNLINJAVE PËR EKONOMINË E THELLUAR

LINJA/NËNLINJA	PESHA NË %
Linja 1	51%
1.1. Qëllimet sociale të një ekonomie	3%
1.2. Kërkesa dhe oferta: si funksionojnë tregjet	17%
1.3. Sjellja konsumatore dhe maksimizimi i dobishmërisë	8%
1.4. Sipërmarrës i suksesshëm. Si të bëhesh i tillë	3%
1.5. Prodhimi, produktiviteti dhe tregu i punës	13%
1.6. Analizë krahasuese e strukturave të tregut dhe rregullimi i monopolit	7%
Linja 2	40%
2.1. Roli i qeverisë në ekonomi, një vështrim i gjerë	6%
2.2. Politika monetare dhe mekanizmi i transmisionit	17%
2.3. Njohuri të thelluara makroekonomike	17%
Linja 3	9%
3.1. Bashkëpunimi ekonomik dhe proceset integruese	3%
3.2. Zhvillimi ekonomik dhe varfëria	6%
Totali	100%